



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 09 DATË 28.02.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK ME NR 52 DATË 02.09.2021 LIDHUR ME GJENERALITETET E SAKTA TË QIRADHËNËSIT (HASAN DERVISHI NGA ARTAN DERVISHI) DHE NDRYSHIMIN E VLERËS SË QIRASË SË AMBIENTIT PRIVAT I CILI DO TË FUNKSIONOJË SI KOPËSHT/SHKOLLË NË FSHATIN GORIÇAN NJËSIA ADMINISTRATIVE KUTALLI**

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike „në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 53, 54 55, Neni 9 pika 1.6(a), Neni 23 pika 12 dhe Nenet 41, 53, 54 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kreu VI, neni 801 e në vijim, Ligji 44/2015” Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr 69/2012”Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Bashkiak Dimal Nr 82 datë 24.12.2021”Mbi miratimin e programit Buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit për vitin 2022”, Kërkesës së Sektorit të Ndihmës Ekonomike të Bashkisë Dimal, administruar me shkresën me Nr 4231/1 Prot datë 17.01.2022”

**VENDOSI**

**Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:**

1. Të miratojë ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Ura Vajguore/Dimal me Nr 52 datë 02.09.2021, lidhur me gjeneralitetet e sakta të qiradhëniësit (Hasan Dervishi nga Artan Dervishi) dhe vlerën e qirasë së ambientit privat, cili do të funksionojë si kopësht/shkollë në fshatin Goriçan, Njësia Administrative Kutalli

2. Të miratojë vlerën e qirasë 22.000 (njëzet e dy mijë)lekë në muaj ,për ambientin e marrë me qira për arsimin parashkollor dhe fillor,vlerë ku do të përfshihen edhe shpenzimet për energji elektrike dhe saktësimin e gjeneraliteteve të subjektit qiradhënës nga Artan Dervishi në Hasan Dervishi’
  
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

